



Lajmet

Operacionet

19/08/2022

Mat – Finalizohet nga Komisariati i Policisë Mat, operacioni policor i koduar “Fokus”

Operacioni, për goditjen e veprimtarisë kriminale të armëmbajtjes pa leje.

Me armë zjarri në brez, kapet në qendër të qytetit të Burrelit dhe vihet në pranga 22-vjeçari nga Tirana.

Sekuestrohen një armë zjarri pistoletë dhe 10 fishekë.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Mat, në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë operative se një shtetas qarkullonte me armë zjarri, kanë organizuar dhe finalizuar me sukses operacionin policor të koduar “Fokus”, si rezultat i të cilit u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit:

-I. R., 22 vjeç, banues në Tiranë, për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, pasi gjatë kontrollit fizik nga shërbimet e Policisë, 22-vjeçarit iu gjetën të fshehura në trup dhe iu sekuestruan një armë zjarri pistoletë “Glock” dhe 10 fishekë.

Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme procedurale.

#angazhimpërkushtimsakrificë 🧑🏫 ♂

#tëvendosurkundërkrimit ✅

#24/7nëçdoskajtëvendit

📱 Share

📘 Share

🐦 Share

📘 Share

✉ Email

Kërko

Enter a word for search

🔍

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent